



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 65 Akti

Nr. 99 Vendimi

Tiranë, më 14.1.2019

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 3 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Anëtare
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia ROESSINGH, më datë 10 janar 2019, ora 09:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alma MUÇA**, prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi dokumentacionin në dosjen e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Alma Muça është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr.84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) hodhi shortin më datë 15.01.2018.

2. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (PP).

3. Me vendimin e trupit gjykues datë 24.01.2018, është caktuar kryesuese znj. Suela Zhegu, si dhe është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

4. Më datë 31.05.2018 subjektit të rivlerësimit i është njoftuar përbërja e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, për të cilin subjekti ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me asnjë prej anëtarëve.

5. Trupi gjykues, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Muça, bazuar në tre kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj. Ajo paraqiti parashtrimet lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Muça, në seancë dëgjimore, më datë 10.01.2019, ora 9:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 10.01.2019, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia ROESSINGH.

9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent. Ajo dha shpjegime në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer dhe rezultatet e hetimit. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të Komisionit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Muça, kërkoi konfirmimin në detyrë.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Gjatë të gjitha fazave të hetimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit.

11. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë të gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Ajo ka respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka dhënë shpjegimet e nevojshme.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës, Aneksin e Kushtetutës, si dhe ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- i) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- ii) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- iii) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme, së bashku me materialin shoqërues;
- iv) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- v) Denoncimet nga publiku;
- vi) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- vii) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- viii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore.

14. Në mbështetje të dispozitave kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nr. 2 dhe nr. 78, të vitit 2017.

A. VLERËSIMI I PASURISË

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Muça, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në

bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

15.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion në raportin e tij ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

16. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Muça, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Subjekti i rivlerësimit znj. Alma Muça jeton me nënën e saj, sipas certifikatës familjare të datës 17.01.2017 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. ***.

Subjekti i rivlerësimit është prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme nga qershori i vitit 2013. Përpara kësaj detyre, znj. Muça ka ushtruar:

- Fillimisht, shtator 1992 - mars 1995, detyrën e hetueses në Prokurorinë Dibër;
- Prill 1995 - qershor 2001, detyrën e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Qershor 2001 - qershor 2013 detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

18. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuritë si vijon:

19. Dy apartamente banimi: a) apartament me sip.96 m²; b) apartament me sip 32m², ndodhur në Rr. “**”, nr.***, në Tiranë.**

Këto pasuri janë pjesë të një shtëpie private (godinë 4-katëshe) të ndërtuar në vitet 1995-1996 nga babai i znj. Muça, së bashku me vëllezërit e tij, mbi truallin e kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave babait të subjektit dhe vëllezërve të tij. Kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të shtetasve S., J., dhe S. M. Vlera e deklaruar e banesës: 2.500.000 lekë.

Në vitin 2011 është bërë rivlerësimi i pasurisë, përkatësisht për apartamentin me sip. 96 m² në vlerën 9.196.800 dhe për apartamentin me sip.32 m², në vlerën 3.200.000 lekë.

20. Burimi i krijimit: nga shitja e një banese në Dibër, në vlerën prej 750.000 lekë si dhe kursime familjare.

20.1 Nga dokumentacioni i depozituar nga ZVRPP-ja Dibër, përcjellë ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 26.09.2017 të ZQRPP-së, është konstatuar se në datën 28.01.2000

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

është shitur një apartament 2+1, në vlerën 750.000 lekë, me bashkëpronarë S., Z., A., A., dhe E. (E.) M.

21. Pas vdekjes së babait, fillimisht në datën 22.03.2017, me nr. *** rep., nr. *** kol., është çelur dëshmia e trashëgimisë, në lidhje me pasurinë e babait të subjektit të rivlerësimit (trashëgimi ligjore). Pasuritë janë ndarë dhe regjistruar në emër të subjektit dhe familjarëve, përkatësisht Alma Muça, A. M., E. M. dhe Z. M.

21.1 Më pas, subjekti dhe familjarët e saj kanë nënshkruar një deklaratë noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2017, ku pjestarët Z., E. dhe A., heqin dorë nga pjesa e tyre për pronën me sip. 32m², duke ia dhuruar pjesëtarit tjetër të familjes, znj. Alma Muça. E njëjta gjë është bërë edhe për apartamentin me sip.96 m² nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2017.

21.2 Këto pasuri janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 13.09.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni

22. Në deklaratën “Vetting” nuk është deklaruar kjo pasuri, pasi subjekti i rivlerësimit e ka përfituar atë pas plotësimit të deklaratës. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklarimin periodik vjetor (për herë të parë) viti 2003, në emër të babait S. M. shtëpi private (3+1), vlera 25.000 lekë, burimi nga shitja e një banese 2+1 si dhe kursime familjare. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me babain.

23. Duke qenë se nga dokumentacioni i administruar nga dosja e ILDKPKI-së, rezultoi shitja e pasurisë në Dibër në datën 28.01.2000 dhe shtëpia rrezulton e ndërtuar rreth viteve 1995-1996, vërehet se ka një mospërputhje deklarimesh.

24. Për këtë u pyet subjekti i rivlerësimit me pyetësorin e datës 20.11.2018, e cila deklaroi se: *“Shitja e apartamentit është bërë në vitin 1995, siç është deklaruar, në vlerën 750,000 lekë, sipas aktit noterial “Kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.1995, të cilën po e vë në dispozicionin tuaj. Pikërisht kjo shumë, si dhe kursime familjare kanë shërbyer për ndërtimin e banesës në Tiranë në vitet 1995-1996, në të cilën kam banuar që prej ndërtimit të saj e ku vazhdoj të banoj edhe aktualisht. Në mbështetje të kësaj, bashkëlidhur po ju dërgoj edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 22.11.2018 të Ujësjetës Kanalizime sh.a Dibër, me të cilin vërtetohet që për vitet 1996-2001, blerësi i apartamentit P. R., ka shlyer detyrimet si abonent me kontratë (shoqëruar edhe me kopje të librit të faturim arkëtimit për vitet përkatëse).*

Sa i takon shitjes së vitit 2000, siç jam informuar nga ana juaj, nuk kam asnjë dijeni as unë e as familjarët e mi, pasi siç shpjegova më lart, shitja e banesës nga ana jonë është realizuar në vitin 1995, sipas kontratës së shitblerjes.”

25. Mbështetur në një dokument të marrë nga ZVRPP-ja Dibër prej ILDKPKI-së, rezulton regjistrimi i shtëpisë në emër të blerësit është bërë mbështetur në aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.01.2000, në të cilin rezulton se kanë firmosur me cilësinë e shitësit shtetasit: S. M., Z. M., Alma Muça, A. M., E. M.

26. Nga hetimi rezultoi mospërputhje në këto deklarime. Referuar nenit D pika 5 të Aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 52 të ligjit nr.84/2016, trupi gjykues i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova apo shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Subjekti ka shpjeguar se sa i përket shitjes së apartamenti në Dibër në vitin 2000, është vënë në dijeni vetëm në momentin e informimit nga Komisioni, me pyetësorin e datës 20.11.2018 dhe se nuk ka patur asnjë dijeni. Pasi është njohur me dokumentin, që në pamje të

parë, me sy të lirë, ka konstatuar falsitetin e dokumentit noterial të vitit 2000, pasi asnjë nga nënshkrimet tek emrat (S., Z., Alma, A. e E. M.) nuk u përkiste atyre.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Ndryshe nga kontrata e vitit 1995, në kontratën e vitit 2000 është përfshirë si bashkëpronar edhe vëllai E. M. (lindur më 19.05.1978) i cili në kohën e privatizimit të banesës nga Enti i Banesave, në vitin 1993, ka qenë nën moshën 18 vjeç. Sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, neni 9, “Banesat që privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe **anëtarëve të tjerë madhorë të familjes....**”. Dhe për më tepër, në këtë periudhë E., ka qenë me studime në Stamboll, Turqi dhe nuk ndodhej fare në Shqipëri (studimet në vitet 1998-2002).”*

28. Znj. Muça ka shpjeguar se ka biseduar me noterin që ka përpiluar kontratën e vitit 2000, i cili ka pranuar dhe ka shpjeguar se: *“Kontrata e vitit 2000, është përpiluar nga ana e tij, me kërkesë të blerësit dhe vetëm në praninë e tij, me të njëjtën përmbajtje si kontrata e rregullt, e përpiluar në vitin 1995 dhe nënshkruar nga palët (S., Z., Alma e A. M.). Kjo për arsye se blerësi P. R., nuk kishte regjistruar banesën në ZVRPP-në Dibër në vitin 1995 dhe ky veprim nuk mund të kryhej në vitin 2000, me kontratën e shitblerjes së vitit 1995.”*

Këto shpjegime noteri i ka formalizuar me aktin “Deklaratë noteriale” nr. *** rep., nr. *** Kol., datë 21.12.2018, që subjekti e paraqiti si provë në Komision.

28.1 Znj. Muça në shpjegimet e saj ka deklaruar se bashkë me nënën dhe vëllain A., kanë paraqitur kallzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, si prokuroria kompetente për hetimin e këtij fakti.²

29. Trupi gjykues pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i pranoi ato dhe i konsideron të plota dhe bindëse për të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Lidhur me këtë pasuri pas vlerësimit të fakteve dhe provave të paraqitura në tërësi, trupi gjykues e konsideron deklarin e subjektit të saktë dhe në përputhje me ligjin.

30. Automjeti KIA Ceed me targë ***, blerë i ri (nga salloni i KIA) në janar 2008. Vlera e deklaruar 17.500 euro. Pjesa që zotëron 100%.

31. Burimi i krijimit: 200 mijë lekë nga shitja e një automjeti tjetër në pronësi (Renault Clio) dhe hua nga babai në vlerën 2.000.000 lekë.

32. Subjekti ka deklaruar se pas shlyerjes së shumës prej 350.000 lekë, pjesa tjetër i është falur. Kontratë huaje nuk ka. Subjekti ka deklaruar se ka jetuar me babain (me të dy prindërit). Znj. Alma Muça ka deklaruar se babai i saj ka patur burime të ligjshme për të justifikuar shpenzimet. Zoti S. M. ka drejtuar Komunitetin Mysliman shqiptar për 10 vjet dhe ka patur një pagë të mirë, por edhe pas largimit ai është trajtuar si “Kryetar Nderi”, duke ruajtur statusin dhe është paguar nga Komuniteti Mysliman me të njëjtën pagë deri në datën 18.9.2017.³

33. Është kërkuar dosja e mjetit nga DPSHTRR-ja dhe është përcjellë nga kjo drejtori.⁴ Është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit paraqitja e dokumentacionit ligjor provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave nga personi huadhënës/dhures në zbatim të nenit 32 pika 4 të ligjit nr.84/2016: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

34. Znj. Alma Muça ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 25.09.2018 të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 24.09.2018 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, të cilat vërtetojnë të ardhurat e babait të saj.

² Për më shumë lexo shpjegimet e subjektit “shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit”.

³ Shkresa nr. *** prot., datë 6.10.2017 e Komunitetit Mysliman Shqiptar.

⁴ Përgjigje nr. *** prot., datë 20.04.2018 e DPSHTRR-së.

35. Nga hetimi i komisionit rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë shumën prej 2.000.000 lekë vajzës së tij.

36. Në përfundim rezulton se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

37. Personi i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit deklaron: apartament me sip. 85,4 m² (sip. e brendshme dhe e përbashkët), në lagjen nr.13, Plazh Durrës, sipas kontratës së sipërmarrjes (premtim shitje) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2014, blerë me kursimet e saja dhe të bashkëshortit.

38. Vlera e deklaruar 28.182 euro. Pjesa që zotëron 100%. Objekti është ende i paregjistruar në ZVRPP-në Durrës.

39. Komisioni hetoi në lidhje me apartamentin në Durrës, duke i dërguar shkresë si Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, ashtu edhe shoqërisë ndërtuese “Rajfi” sh.p.k.,⁵ pasi konstatohet se pagesa për këtë apartament është kryer *cash*.

40. Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.⁶ konfirmon se shuma në vlerën 28.182 euro është arkëtuar në arkën e shoqërisë në datën 17.07.2007, duke paraqitur kontratën e sipërmarrjes të vitit 2014, lejen e ndërtimit si dhe një mandat arkëtimi për shumën prej 28.182 euro. Pagesa konfirmohet edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

41. Është pyetur subjekti i rivlerësimit dhe ka kthyer përgjigje lidhur me këtë apartament, burimin e ligjshëm, kontratën e shitjes dhe regjistrimin e kësaj pasurie.

42. Subjekti ka sqaruar se shtëpia është paguar nga kursimet e dy prindërve, kryesisht të babait nga të ardhurat që ka përfituar nga puna në Komunitetin Mysliman Shqiptar. Deri tani ky apartament nuk ka qenë i regjistruar në hipotekë, ndaj nuk është lidhur as kontrata e shitjes.

43. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 25.09.2018 të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 24.09.2018 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, lidhur me të ardhurat e babait.

44. Nga hetimi dhe analiza financiare e Komisionit, rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka patur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

45. Pasurinë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

- Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) - vlera 5,000,000 (pesë milion) lekë. Zotëron 100% znj. Alma Muça. Krijuar nga bashkimi i depozitës në Bankën Raiffeisen dhe kursimet e pagës në Bankën Credins.
- Depozitë në BKT, krijuar nga kursimet e pagës në Credins Bank për vitin 2014 dhe kursimet e pagës po në këtë bankë deri në muajin gusht 2015. Vlera e deklaruar 1.400.000 lekë. Zotëron 100% znj. Alma Muça.
- Të ardhura (interesa) nga dy depozitat në BKT. Vlera 216.157 lekë. Zotëron 100% znj. Alma Muça.
- Kursime nga paga në llogarinë rrjedhëse Credins deri më datë 20.01.2017 në vlerën 994.493 lekë. Zotëron 100% znj. Alma Muça.

- ✓ Të ardhurat nga paga të znj. Alma Muça, nga shtator 1992 kur është emëruar hetuese në Dibër e deri në vitin 2016 në Prokurorinë e Përgjithshme kanë qenë në vlerën 18.459.283 lekë.

⁵ Shkresë nr. ***, datë 21.02.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave
Shkresë nr. ***, datë 22.02.2018 drejtuar Shoqërisë “****” sh.p.k.

⁶ Përgjigje nr. ***, datë 09.03.2018 e shoqërisë “****” sh.p.k., dhe përgjigje e datës 7.12.2018, e kësaj shoqërie

- Depozitë në BKT, e nënës së subjektit të rivlerësimit, krijuar më datë 23.11.2016, nga kursimet e saja dhe të bashkëshortit (ndarë nga jeta në muajin shtator 2016). Vlera 5.000 euro. Pjesa që zotëron 100%.
- ✓ Të ardhurat nga pagesa e pensioneve për znj. Z. M., nga 16.08.1992 deri në muajin janar 2017 kanë qenë në vlerën 2.721.727 lekë.

46. Nga hetimi administrativ mbi pasurinë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur rezulton se përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, me përgjigjet e ardhura nga bankat, si dhe mundësitë financiare të tyre.

47. U verifikuan udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, ku rezultuan disa udhëtime nga për arsye pune dhe disa udhëtime private, të cilat ishin kryesisht drejt Turqisë. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se në këto udhëtime ka shkuar në banesën e vëllait të saj, E.M. (diplomat/këshilltar në Ankara dhe Konsull i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Stamboll, nga viti 2005-2014).

48. Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi: në vitin 2006 një minus në vlerën 61,072 lekë, në vitin 2007 një minus në vlerën 263,888 lekë dhe në vitin 2012 një minus në vlerën 163,252 lekë. Komisioni e konsideron këto vlera të arsyeshme, pasi të ardhurat e subjektit kanë shërbyer për të mbuluar shpenzime jetike dhe se znj. Muça ka jetuar në shtëpi me prindërit dhe ata kanë patur të ardhura të mjaftueshme (megjithëse analiza financiare është bërë e ndarë).

49. Znj. Muça ka sqaruar gjithashtu se kursimet e disponuara nga ajo në banesë në shumën 800,000 lekë të deklaruara nga ajo në DPV-në e vitit 2004, do të ishin të mjaftueshme për të përballuar diferencën negative apo pamjaftueshmërinë financiare të rezultuar nga analiza financiare, që në total arrin në shumën -488,212 lekë.

50. Trupi gjykues vlerësoi se analiza financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementët që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale, ndaj ajo duhet vlerësuar në tërësi duke iu referuar rrethanave konkrete. Mungesa e likuiditeteve në masën -488,212 lekë është në një masë të pranueshme.

51. Hetimi administrativ kryesisht i kryer nga Komisioni u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

52. Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Ujësjellës – Kanalizime sh.a. Tiranë.

53. Nuk rezulton nga ndonjë burim që ky subjekt të ketë pasuri të paluajtshme, të fshehura apo të padeklaruara, të mbajtura nga persona të tjerë.

54. Gjatë hetimit u konstatuan disa pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit si:

A - Subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës ka deklaruar lekë gjendje për nevoja të ngutshme në vlerën 8 milion lekë, të kursyera nga paga vjetore, të mbajtura *cash*. Kjo shumë e deklaruar nuk përmendet në deklaratat pasardhëse gjatë viteve apo qëllimi për të cilin është përdorur.

Për këtë qëllim, është pyetur subjekti nëpërmjetë komunikimeve elektronike.

Në përgjigjet e datës 19 tetor 2018, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Për sa i përket vlerës 8 milion lekë gjendje cash, të deklaruar nga ana ime në formularin A-5 në deklaratën para fillimit të detyrës, si kursime nga paga vjetore, theksoj se, bëhet fjalë për vlerën 8 milion lekë të vjetra (800 mijë lekë të reja).*

Deklarimi, i pari i këtij lloji, është bërë duke iu referuar faktit se në krye të kolonës ku është pasqyruar kjo vlerë shkruhet “Vlefëta në milion/lek ose valutë” dhe nga ana ime është plotësuar duke iu referuar strikt sa shkruhej më lart, pa e specifikuar lek i ri apo i vjetër. Në vijim të këtij argumenti, në po të njëjtën deklaratë, në formularin A-6 “Të ardhura personale nga paga...” në kolonën ku kam pasqyruar pagën ku shkruhet “Shuma gjithsej milion/lek “, kam deklaruar pagë 709110 që e lexuar strikt siç shkruhet më sipër, nënkupton pagë 709 milion lekë, gjë që është e pamundur.

*Kjo mënyrë plotësimi në të dy rastet lidhet me paqartësitë për **formën e të shkruarit** të vlerave, si deklaratë e parë që duhej plotësuar lidhur me pasurinë dhe formulari nuk ka qenë i qartë për mënyrën si duhen shkruar vlerat.*

Ndërsa për sa i përket përdorimit të shumës si më sipër (8 milion lekë të vjetra), nuk ka pasur destinacion të veçantë, por është përdorur për shpenzime të zakonshme familjare (ushqime, veshje, pushime etj.) Përdorimi i kësaj shume për këto shpenzime (nuk mund të përcaktoj me saktësi në çfarë afati kohor shtrihet shpenzimi i tyre) më ka krijuar mundësinë për të realizuar kursime nga paga, sipas deklaratimeve periodike në vijim.”

B - Vërtetimet e Komunitetit Mysliman, ai i administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe ai i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, mbi të ardhurat e babait kanë mospërputhje në vlerat e përcaktuara në to. Konkretisht vërtetimi nr. *** prot., datë 06.10.2017 dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 25.09.2018.

Me qëllim saktësimin e të ardhurave të përfituara, është pyetur nëpërmjet komunikimit elektronik subjekti i rivlerësimit.

Në përgjigjet e datës 19 tetor 2018, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Lidhur me saktësinë e dy vërtetimeve për të ardhurat e babait tim, lëshuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, shpjegoj se në analizë të të dy vërtetimeve, konstatohet se nuk paraqiten të ardhura të ndryshme. Në përgjigjen për ILDKPKI-në, janë pasqyruar vetëm pagat gjatë kryerjes së detyrës së Kryetarit dhe Kryetarit të Nderit të KMSH-së, duke nxjerrë pagën mesatare mujore neto 80 mijë lekë, për të gjitha vitet në këtë detyrë.*

Vërtetimi i paraqitur nga ana ime me përshkrimin e detyrave të kryera, afatet kohore, si dhe të dhënat tabelore, përmban të dhëna të detajuara, për pagat që nga fillimi i detyrës në këtë institucion, në pozicione të ndryshme, që nga viti 1992, si dhe shpërblimet e ndryshme ndër vite. Pra, vërtetimi i paraqitur nga ana ime, përmbledh dhe sa është pasqyruar në përgjigjen për ILDKPKI-në.

Shtoj se, duke mos njohur kërkesën e ILDKPKI-së, drejtuar KMSH-së, mendoj se bëhet fjalë vetëm për pagën e kërkuar gjatë ushtrimit të funksionit të Kryetarit dhe Kryetarit të Nderit. Dua të saktësoj njëkohësisht se ka një lapsus në vitin e ndarjes nga jeta të babait tim, që është viti 2016 dhe jo 2017 (referencat datë/muaj janë të sakta), siç është shënuar në shkresën për ILDKPKI-në.”

C - Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhurat nga paga në deklaratat periodike vjetore të viteve 2013 dhe 2014.

Në emailin e datës 20.11.2018 subjekti ka shpjeguar se: *“Sa i takon mosdeklarimit të pagave për vitet 2013-2014, sipas DPV-së dorëzuar në ILDKPI, këto lidhen me harresë nga ana ime në plotësimin e tyre. Në të dy rastet kam deklaruar kursimet nga paga për secilin vit, duke cilësuar si burim për krijimin e tyre pagën, por nuk kam plotësuar vlerën e të ardhurave neto për secilin vit.*

Lidhur me deklaratën e vitit 2014, jam vënë në dijeni të faktit nga ILDKPKI-ja dhe jam thirrur për sqarime në këtë institucion, sipas deklaratës datë 26.01.2016, para inspektores A. C. Pas

spjegimeve, kam paraqitur vërtetimin e pagës neto, të përfituar për vitin 2014, në zyrën e protokollit të këtij institucioni, bashkë me dokumente të tjera të kërkuara prej tyre.

Edhe në deklaratën e vitit 2013, është e njëjta situatë, madje sqaroj se fillimisht kam plotësuar deklaratën e vitit 2013 e më pas atë të vitit 2014 dhe për shkak të plotësimit në mënyrë elektronike, duke punuar mbi deklaratën paraardhëse në të dy rastet është e njëjta mënyrë plotësimi. Për këtë deklaratë nuk jam njoftuar nga institucioni, sipas parashikimeve ligjore të nenit 27, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2013 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, siç është vepruar në rastin e vitit 2014.

Nga verifikimi i DPV-së të vitit 2013, pas njoftimit tuaj, konstatoj të njëjtën mangësi, duke deklaruar kursimet nga paga për vitin 2013, por nuk kam plotësuar vlerën e të ardhurave neto për këtë vit. Bashkëlidhur po dërgoj vërtetimet për pagat e këtij viti (të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokurorisë së Përgjithshme).

E konsideroj harresë në plotësimin e deklaratave përkatëse, pasi paga është e ardhur e ligjshme, e verifikueshme në çdo moment, mbi të cilën aplikohen tatime, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe nuk kam pasur asnjë arsye që të mos i deklaroj. Gjithashtu, deklarata “Vetting” e dorëzuar me datë 25.01.2017 në ILDKPKI nga ana ime, është e shoqëruar krahas dokumenteve të tjerë edhe me vërtetimet e pagave të çdo viti që nga momenti i fillimit të detyrës, ku përfshihen edhe pagat e viteve 2013 e 2014.”

55. Subjektit të rivlerësimit iu dërgua nëpërmjet adresës zyrtare të e-mail-it edhe një pyetësor-tip dhe nga përgjigjet e këtij pyetësori, deklaratimet rezultuan të ishin korrekte dhe në përputhje me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

56. Në përfundim, trupi gjykues, arrin në përfundimin se: nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Ajo ka kryer deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultoi të jetë e ligjshme, nuk ka deklaratim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

57. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

58. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/206 dhe ka dërguar një raport të arsyetuar me nr. *** prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 11.04.2018 të KDZH-së, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Muça”.

58.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konstatimi i Komisionit:

59. Në media është përmendur një çështje e trajtuar në Gjykatën e Lartë, ku Prokuroria e Përgjithshme e përfaqësuar nga prokurori A. S. ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale, duke aluduar se veprimet kanë qenë të qëllimshme për të favorizuar palën e akuzuar. Në këtë informacion përmendet edhe prokurorja Alma Muça, asaj kohe drejtore e Drejtorisë Gjyqësore dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale, në Prokurorinë e Përgjithshme.

60. Ndaj këtyre informacioneve dhe aludimeve mediatike ka patur edhe një kallzim penal nga familjarë të palës tjetër në këtë proces gjyqësor, të cilët pretendojnë se disa prokurorë dhe gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, përfshirë këtu edhe znj. Alma Muça, kanë tentuar të kryejnë një aferë korruptive në gjykimin e çështjes penale në Gjykatën e Lartë me të pandehur A. B. etj.

61. Është vërejtur gjithashtu edhe një lajm “*Prokurori i Përgjithshëm pezullon nga detyra dhe nis hetimin për dy prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme*”, duke iu referuar subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Muça dhe prokurorit A. S.

62. Për këto arsye është kërkuar një kopje e dosjes penale që i përket kallzimit penal nr. *** regjistruar më datë 10.10.2017, të bërë nga shtetasit I. V., dhe B. R., në të cilën është vërejtur se pas përfundimit të hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është vendosur mosfillimi i kallzimit penal nr. ***, datë 10.10.2017, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

63. Në dosje është vërejtur se pavarësisht se kallëzimi drejtohej ndaj dy prokurorëve z. A. S. dhe znj. Alma Muça, prokurori i çështjes ka qenë A. S. Pozicioni i prokurores Alma Muça ka qenë ai i eprorit direkt të prokurorit të çështjes. Gjatë trajtimit të çështjes prokuroria ka arsyetuar se: “*Organi procedues konstatoi se nuk ka prova dhe as indicie të rëndësishme që lidhin qëndrimin në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë të prokurorit A. S., me ndërhyrje të paligjshme, me kërkime apo pranime për përfitime të paligjshme të çfarëdo lloji për të patur atë qëndrim në seancë. Vetëm fakti i qëndrimit krejtësisht të kundërt të prokurorit në seancë gjyqësore me qëndrimin e prokurorit të çështjes në shkallë të parë apo prokurorit të apelit, nuk mund në asnjë rast të konsiderohen të tilla që të përmbajnë elementë të ndonjë veprë penale.*”

64. Lidhur me këtë indicie të marrë mediatikisht është pyetur nga Komisioni edhe subjekti i rivlerësimit, me pyetësorin e datës 10.09.2018, se cili ka qënë pozicioni dhe qëndrimi i saj në këtë çështje referuar ligjit nr.97/2016, si dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe a ka konfirmuar ajo qëndrimin e prokurorit të çështjes si drejtuese e tij në atë kohë, pa paragjykuar pavarësinë e prokurorit në bindjen e tij të brendshme lidhur me çështjet objekt shqyrtimi.

65. Në përgjigjen e datës 18.09.2018, subjekti i rivlerësimit është shprehur se:

“Mendimi/qëndrimi i prokurorit lidhur me rekursin e ushtruar nga prokurori i Apelit Vlorë, si dhe nga mbrojtësit e të pandehurve A. Ll., A. B., e B. A., **ka qënë vetëm i prokurorit të caktuar me short, i pandikuar dhe i pakonfirmuar nga ana ime**, në cilësinë e drejtorit të drejtorisë, për arsyet e mëposhtme:

Gjykimi i çështjes është zhvilluar në Gjykatën e Lartë më datë 15.02.2017, kohë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 45, pika 1, të këtij ligji përcaktohet “pavarësia procedurale e prokurorëve”.

Në rastin konkret nuk më është paraqitur mendimi i prokurorit me shkrim e as akte të dosjes, për të më krijuar mundësinë e dhënies së një mendimi/opinionit/udhëzimit me shkrim. Nëse do kishte një procedurë siç parashikon ligji dhe udhëzimi në zbatim të tij, do kishte edhe komunikimet me shkrim, bashkëlidhur mendimit. Por në çdo mënyrë, *udhëzimet për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme për prokurorin e çështjes.*

Nga sa sipër, me ndryshimet në ligj, drejtori, nuk ka asnjë kompetencë dhe mjet ligjor për të *ndikuar* apo për të *imponuar* në qëndrimin e prokurorit të seancës gjyqësore, pranë Gjykatës së Lartë, pasi edhe udhëzimet për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme për prokurorin e çështjes/seancës dhe ato në çdo rast jepen me shkrim.

Nga ana tjetër, edhe sikur të vazhdonte të zbatohet ligji nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimi nr.1, datë 14.11.2008 “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit”, të Prokurorit të Përgjithshëm, në pikën 12 të këtij udhëzimi përcaktohet detyrimi për informimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Pra, edhe nëse do ishte në fuqi ky ligj, procedura që do ndiqej nga unë në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Gjyqësore, do ishte si më sipër e jo një *konsultim apo diskutim* me prokurorin e seancës gjyqësore.

Për më tepër, nga ana e prokurorit të çështjes, në cilësinë e përfaqësuesit të Prokurorisë, në gjykimin e çështjes penale me të pandehur A. Ll. etj., *në asnjë moment* nuk më është paraqitur mendimi i tij, as në formë elektronike e as në format letër. Kjo pikërisht se, *sipas ligjit të ri, prokurori është i pavarur në seancë gjyqësore, dhe si rrjedhim nuk ka detyrim ligjor konfirmimit e qëndrimit të tij nga drejtori.*”

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto dokumente:

- Kopje të konkluzioneve të prokurorit të paraqitura në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë (kopje e njëzuar me origjinalin, e marrë nga subjekti i rivlerësimit nga fashikulli në Gjykatën e Lartë).
- Vërtetim nr. ***, datë 12.09.2018 lëshuar nga sektori i burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, ku vërtetohet se subjekti nuk ka qenë e pezulluar nga muaji shkurt 2017 e në vijim.
- Kopje e njoftimit të Gjykatës Administrative Tiranë, ku subjekti është ngarkuar më datë 04.03.2017 nga Prokurori i Përgjithshëm për përfaqësimin e një çështjeje administrative në gjykim (pra, që i ishte caktuar një çështje gjyqësore).
- Shkresë nr. ***, datë 17.09.2018 e sektorit të protokoll-arkivit, në Prokurorinë e Përgjithshme, nga ku rezulton se nuk janë protokolluar në regjistrin e korrespondencës dhe as arkivuar konkluzionet e prokurorit në seancën gjyqësore ndaj të pandehurve A. Ll. etj. zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

66. Lidhur me njoftimin mediatik se Prokurori i Përgjithshëm pezullon nga detyra dhe nis hetimin për dy prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, nga hetimi rezultoi se për këtë rast, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 23.02.2017, për veprat penale të parashikuara nga nenet 244, 248 e 259 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. S.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

67. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit ishin të mjaftueshme dhe bindëse për trupin gjykues.

68. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

69. Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Alma Muça.

70. Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit prokurorja Alma Muça ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 (tre) dokumente ligjore, të llojit “Vendim”.

1. Dokument ligjor: Vendim nr. *, datë 07.04.2014 “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë”,** në lidhje me procedimin penal nr. *** datë 08.12.2013 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale të “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar respektivisht nga nenet 290/2 dhe 291 të Kodit Penal, mbi bazën e materialeve të dërguara nga policia gjyqësore, pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë.

Dokumenti ligjor, vendim, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, si prokuror më i lartë, ka ushtruar kompetencën për mospranimin e ankimit, lënien në fuqi dhe zbatimin e vendimit të drejtuesit për shfuqizimin e vendimit të pushimit, njohjen me këtë vendim të Drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe prokurorit ankues si dhe përcjelljen e akteve të procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, pjesët e tij janë të ndara me emërtim nga njëra-tjetra, paragrafët janë të ndarë dhe të numërtuar rregullisht, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, Kodit Rrugor, parashtrohen provat, përmenden elementët e veprës penale që merret në analizë, duke i ndërthurur me rezultatet e provave.

2. Dokument ligjor: Vendim nr. *, datë 12.01.2015 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe caktimin e kompetencës tokësore”,** në lidhje me procedimin penal nr. *** datë 27.05.2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor, vendim, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, si prokuror më i lartë, ka ushtruar kompetencën për caktimin e prokurorisë kompetente për zhvillimin e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale, dërgimin e vendimit dhe akteve prokurorisë kompetente dhe njohjen me këtë vendim të të dyja prokurorive në konflikt kompetence.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, pjesët e tij janë të ndara me emërtim nga njëra-tjetra, paragrafët janë të ndarë dhe të numërtuar rregullisht, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, parashtrihen provat, merren në analizë duke bërë një çmim të tyre në raport me njëra-tjetrën dhe duke çmuar fuqinë provuese të secilës prej tyre.

3. Dokument ligjor: Vendim “Për miratimin e rezultateve të verifikimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015”, datë 20.12.2016, në lidhje me aktet e verifikimit nr. *** të shtetasit D. T.

Dokumenti ligjor, vendim, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, ka disponuar mbi përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin e faktit se subjekti deklarues përfshihet në fushën e ndalimit të parashikuar në dispozitën ligjore. Ka disponuar gjithashtu mbi njoftimin e kërkesës.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në paragrafë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim dispozitat përkatëse të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dispozitat penale dhe ato të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”.

71. Më datën 11.01.2018, në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, u përzgjedhën 5 (pesë) akte, në kategoritë “konflikt kompetence”, “vendim për shfuqizim vendim pushimi”, “urdhër pezullimi i prokurorit”, 2 (dy) akte inspektimi.

1. Kallëzimi penal nr. * datë 01.07.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë**, i regjistruar për veprën penale të “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor, vendim, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, si prokuror më i lartë, ka ushtruar kompetencën për caktimin e prokurorisë kompetente për zhvillimin e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale, dërgimin e vendimit dhe akteve kësaj prokurorie dhe njohjen me këtë vendim të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, pjesët e tij janë të ndara me emërtim nga njëra-tjetra, paragrafët janë të ndarë dhe të numërtuar rregullisht, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, parashtrihen provat, mënyra me të cilën ka proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë për verifikimin e materialit dhe mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore, arsyetohet mbi kompetencën territoriale në përputhje me vendin ku ka ndodhur fakti i kallëzuar.

2. Procedimi penal nr. * datë rregjistrimi 31.05.2013**, për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. D., i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Dokumenti ligjor, vendim, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, si prokuror më i lartë, ka ushtruar kompetencën për shfuqizimin e vendimit të pushimit, vazhdimin e mëtejshëm të veprimeve hetimore, dërgimin e vendimit së bashku me aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe njohjen me këtë vendim të ankuarit.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, pjesët e tij janë të ndara me emërtim nga njëra tjetra, paragrafët janë të ndarë dhe të numërtuar rregullisht, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, Kodit Rrugor, ligjin organik dhe akte nënligjore, parashtrihen provat, mënyra me të cilën ka proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për kryerjen e veprimeve hetimore, duke nxjerrë në pah mangësi që vlerëson se ekzistojnë, arsyetohet qartë mbi vendimmarrjen e prokurorit të shkallës së parë dhe mbi veprimet hetimore që duhen kryer në vijimësi.

3. Urdhër nr. * datë *** “Për pezullim nga detyra të prokurorit P. V.”.**

Dokumenti ligjor, urdhër, është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, si prokuror më i lartë, ka ushtruar kompetencën për pezullimin nga detyra të prokurorit deri në përfundimin e procedimit penal dhe njohjen me këtë urdhër të prokurorit të pezulluar.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, pjesët e tij janë të ndara me paragrafë, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, ligji organik, parashtrihet fakti, mënyra me të cilën ka proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Respektohen rregullat e drejtshkrimit.

4. Aktkontrolli “Për treguesit e punës të prokurorit pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë F. M.” i kryer në bazë të urdhrin nr. * datë *** “Për ushtrimin e kontrollit të punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë” .**

Dokumenti ligjor, aktkontrolli, përbëhet nga tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe konkluduese.

Në pjesën konkluduese, prokurorja Alma Muça, subjekt rivlerësimi, jep mendimin e saj mbi nivelin profesional të prokurores F. M. që i është nënshtruar këtij kontrolli.

Nga përmbajtja e dokumentit ligjor aktkontrolli, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Përdoren përgjithësisht të gjitha gjerat e gjuhës shqipe.

Fjalitë paraqiten të qarta dhe me lidhje logjike, përmbajnë referenca ligjore, penale, procedurale penale, evidenton aktet nënligjore. Teksti paraqitet i kuptueshëm dhe i ndarë në paragrafë.

Ka argumentuar qartë qëndrimin e prokurores që i është ushtruar kontrollit, duke u mbështetur në aktet përkatëse.

5. Aktkontroll “Për treguesit e punës të prokurorit pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë N. Gj.” i kryer në bazë të urdhrin nr. ***, datë *** “Për ushtrimin e kontrollit të punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë” .

Dokumenti ligjor, aktkontrolli, përbëhet nga tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe konkluduese.

Në pjesën konkluduese, prokurorja Alma Muça, subjekt rivlerësimi, jep mendimin e saj mbi nivelin profesional të prokurorit N. Gj. që i është nënshtruar këtij kontrolli.

Nga përmbajtja e dokumentit ligjor akt kontrolli, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Përdoren përgjithësisht të gjitha germat e gjuhës shqipe.

Në përgjithësi fjalitë paraqiten të qarta dhe me lidhje logjike, përmbajnë referenca ligjore, penale, procedurale penale. Teksti paraqitet i kuptueshëm dhe i ndarë në paragrafë.

Ka argumentuar qartë qëndrimin e prokurori që i është ushtruar kontrollit, duke u mbështetur në aktet përkatëse.

ANALIZA E GJETJEVE

72. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve/praktikave të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 5 akte të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3”. Ndërsa dosjet/praktikat e vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4, dosja 5”.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Alma Muça ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej saj si dhe në 5 dosjet/praktikat e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi elementëve të veprës penale në përputhje me provat, për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore.

Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej saj, në respektim të dispozitave procedurale penale dhe akteve nënligjore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Alma Muça ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj.

Aktet e përpiluara prej saj, konceptohen të ndara në pjesë, të qarta, të identifikueshme me emërtimin përkatës. Përgjithësisht, paragrafët ndahen me numra. Në tekstet e akteve ekziston

lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurorja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi Alma Muça, për periudhën e rivlerësimi 08.10.2013 – 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurores në Drejtorinë e Hetimit përgjatë periudhës 08.10.2013 deri më 12.01.2015 dhe detyrën e Drejtores në Drejtorinë e Inspektimit përgjatë periudhës 12.01.2015 e deri më datë 08.10.2016.

Ajo ka trajtuar gjithsej 1356 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) çështje.

Konstatohet se prokurorja Alma Muça, subjekt rivlerësimi, për periudhën e rivlerësimi, nuk ka ushtruar ndjekje penale në hetim për shkak të funksionit që ka kryer. Ajo ka ushtruar detyrën si prokuror më i lartë, në rastet e zgjidhjes së konfliktit të moskompetencës, marrjen në shqyrtim të ankimeve nga palët në proces apo prokurorët, vendosjen e shfuqizimeve si dhe ka kryer kontrollë në respektim të urdhërave të Prokurorit të Përgjithshëm në prokuroritë e shkallëve më të ulëta.

Mbështetur në urdhrin nr. 148 datë 09.05.2008 “*Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori*”, kreu I, pika 2, përcaktohet se prokurorët, drejtues të drejtorive dhe sektorëve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, drejtues të Prokurorive të apeleve dhe drejtues të Prokurorive të shkallës së parë, janë prokurorë më të lartë se prokurorët në strukturat përkatëse që ata drejtojnë. Sipas kreu II, pika 2, Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, sipas grup veprave dhe drejtimeve që mbulojnë, ushtrojnë ndihmë metodike dhe kontroll në prokuroritë e niveleve më të ulëta, ushtrojnë funksione, kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara në Kushtetutë e në ligj, në këtë urdhër ose që u delegohen posaçërisht nga Prokurori i Përgjithshëm.

Nga aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimi dhe dosjet/aktet e shortuara, ka rezultuar se ajo ka ushtruar funksionin, mbështetur në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nënligjore, që e përcaktojnë atë si prokuror më i lartë me fuqinë e ndryshimit ose shfuqizimit të vendimeve të marra nga prokurori më i ulët si dhe mbështetur në ligjin nr. 8737, datë 12.02.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, etj.

Mbështetur në ligjin nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, neni 8, organi kompetent është i detyruar që t'i kërkojë brenda 5 ditëve Prokurorisë së Përgjithshme verifikimin e të dhënave sipas këtij ligji. Përfundimet e procesit të verifikimit i përcillen organit përgjegjës nga Prokuroria e Përgjithshme brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre. Për kryerjen e verifikimeve, Prokuroria e Përgjithshme përdor çdo të dhënë apo dokumentacion në dispozicion të saj ose i kërkon ato pranë çdo organi apo entiteti tjetër shtetëror, brenda apo jashtë vendit. Në këtë kuadër, prokurorja Alma Muça, subjekt rivlerësimi, ka ushtruar detyrën, duke kryer verifikimet përkatëse, për subjektet për të cilat është kërkuar verifikimi në bazë të ligjit të sapocituar.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, prokurores Alma Muça, subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNj-së, akte këto të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ajo ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i saj është shprehur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon Prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurori të detyrohet të arsyetojë aktet e tij. Konstatohet se aktet janë marrë brenda afateve ligjore.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit prokurorja Alma Muça është efiçente dhe efektive. Në efektivitetin dhe efiçencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat administrative/drejtuese

Sipas vlerësimeve të punës së subjektit Alma Muça, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton shumë mirë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Alma Muça, nuk ka pasur në administrim përfundimtar dosje. Administrimi i akteve që janë përpiluar prej saj, rezulton të jetë bërë në mënyrë të rregullt duke i bashkalidhur aktet shtesë që e kanë iniciuar punën e saj.

3. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në dosjet e vëzhguara, në format letër dhe në dokumentet e dorëzuara prej subjektit të rivlerësimit, prokurorja Alma Muça, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentet ligjore dhe në dosjet e urdhërat e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit prokurorit Alma Muça për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

73. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. *** prot., të datës 02.03.2018 ka dërguar informacion se ndaj subjektit Alma Muça është regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, viti 2017, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit (i cili është trajtuar më sipër) më datë 25.10.2017.

Pranë sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr.8737 datë 12.02.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*” si dhe Urdhrit nr. 221 datë 19.11.2012 “*Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve*”.

Pranë këtij sektori, lidhur me ankesat, për subjektin e rivlerësimit, nga viti 2006 – 2018, janë nxjerrë në mënyrë manuale nga regjistrat e korrespondencës së ankesave, si më poshtë vijon:

- i. nr. ***, viti 2013 me ankues shtetasin T. M.;
- ii. nr. *** viti 2012, 2013 me ankues shtetasen M. K.

Sa i përket ankesës së shtetasit T. M., nga praktika përkatëse rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 19.06.2013, Drejtoria e Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kompetencë e zgjidhje ligjore letrën drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm të shtetasit T. M., duke vënë në dijeni se ankohet për shtyrje të padrejtë të seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së paraqitjes të prokurorit të çështjes, në çështjen me të akuzuar ankimesin dhe dy familjarët e tij.

Sa i përket ankesës së shtetasen M. K., nga praktika përkatëse rezulton se, shtetësja M. K., ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme ankim kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit penal nr. *** datë 12.07.2011 të Njësisë Rajonale të Policisë Rrugore Tiranë.

Nga sektori i marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, me informacionin datë 11.10.2012 është vlerësuar që ankesa e shtetasen M. K., të kalojë për trajtim në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimeve dhe Ndjekjes Penale. Kjo drejtori, me shkresën nr. *** prot. datë 11.12.2012 ka kërkuar për studim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktet e kallëzimit penal nr. *** datë 12.07.2012, i mosfilluar. Aktet janë përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Prokurori i Përgjithshëm me vendimin “*Për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal*” datë 28.01.2013, pas shqyrtimit të akteve të kallëzimit penal nr. ***, viti 2011 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin është vendosur mosfillimi penal dhe ankesën të paraqitur nga shtetësja M. K., bazuar në nenin 24 pikat 4 e 5 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal lidhur me materialin referues nr. *** të vitit 2011, regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, duke urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë të kryejë veprimet e nevojshme hetimore për këtë procedim penal.

Prokurore Alma Muça, në vendimin e mosfillimit arsyeton se: “*...nuk ndodhemi para veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Kjo për faktin se nga ana e drejtuesit të mjetit E. L., nuk janë shkelur rregullat e qarkullimit rrugor. Kurse, këmbësori K. R., megjithëse është i dëmtuar, është në shkelje të rregullave të qarkullimit, sipas përcaktimit në aktin e ekspertimit autoteknik. Në këto kushte, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, meqenëse mungon lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë midis shkakut dhe pasojës, ndjekja penale për këtë rast nuk mund të fillojë*”.

Në vendimin e shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, Prokurori i Përgjithshëm çmon se vendimi i prokurores së çështjes për mosfillimin e procedimit penal, miratuar nga drejtuesi i saj është i pabazuar në rrethana fakti të verifikuara dhe në shkelje të ligjit procedural penal, neneve 1, 2, 24 pika 1 e 290 pika 1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale. Konstaton se vendimi është marrë pa u kryer verifikimet e nevojshme për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi mekanizmin e ngjarjes, shkakun e aksidentit dhe pasojës së ardhur në dëm të shtetasit K. R.

Ky vendim dhe aktet e materialit kallëzues nr. *** të vitit 2011 janë dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** ex-*** prot., datë 28.01.2013. Një kopje e vendimit i është dërguar për dijeni shtetasen M. K. me shkresën nr. *** ex-*** prot., datë 28.01.2013 të Prokurorit të Përgjithshëm. Në memon nr. *** ex-*** prot., datë 05.03.2013 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori A. P., prokuror i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimeve dhe Ndjekjes Penale, ka vlerësuar se vendimi datë 28.01.2013 e Prokurorit të Përgjithshëm bashkëlidhur aktet përkatëse të administrohet në Drejtorinë e Inspektimit dhe

Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme, për t'u konsideruar në vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale të prokurores Alma Muça, në mbështetje të neneve 46 pika 1-1.3 dhe 50 pika 1 të Rregullores “Për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale

74. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

75. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Muça: “E aftë”.

76. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr.84/2016.

DENONCIME TË PARAQITURA PRANË KOMISIONIT

77. Pranë Komisionit janë paraqitur 3 denoncime për subjektin e rivlerësimit si më poshtë vijon:

- Denoncimi nr. *** prot., datë 22.11.2017;

Ky denoncim iu referohet katër subjekteve të rivlerësimit.

Ankuesi është ankuar për subjektin e rivlerësimit edhe në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me mungesën e subjektit të rivlerësimit në seancat gjyqësore, fakt i cili është paraqitur edhe më lart në vlerësimin profesional. Më pas, është caktuar prokuror tjetër për çështjen penale përkatëse dhe janë ezauruar të trija shkallët e gjyqësorit.

Znj.Muça ka sqaruar se mosparaqitja në seancat gjyqësore gjatë gjykimit të çështjes, lidhet me transferimin e saj nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në Prokurorinë e Përgjithshme, me Dekret të Presidentit të Republikës, nr. 8200, datë 28.05.2013, e se për atë çështje është caktuar një prokuror tjetër.

- Denoncimi nr. *** prot., datë 02.02.2018;

Ky denoncim iu referohet 18 subjekteve të rivlerësimit me objekt “korrupsion dhe kontroll të figures”. Subjekti parashtron se ka paraqitur disa kallëzime penale, pa i specifikuar ato. Sa rezulton nga ankesa, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendime mosfillimi në dëm të shtetasit V. Ç. Ai shprehet gjithashtu se ky vendim mban datën 15.09.2004. Vendimi i mosfillimit është trajtuar në denoncimin e mëposhtëm.

- Denoncimi nr. *** prot., datë 08.02.2018, me objekt korrupsion dhe kontrolli i figures;

Ky denoncim iu referohet 12 subjekteve të rivlerësimit. Ankuesi shprehet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin e datës 12.10.2004, ankuesi e ka ankimuar në gjykatë. Por nuk ka qenë dakord me gjyqtaren e caktuar. Nga dokumentacioni bashkëlidhur konstatohet se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. Ç., të datës 15.09.2004 është regjistruar në Prokurorinë e

Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimi nr. ***, datë 15.09.2004. Objekt kallëzimi kanë qenë veprimet e policisë ndërtimore dhe shoqërisë së ndërtimit “ *** ” sh.p.k.

Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se veprimet e kryera nga Policia Ndërtimore janë veprime të ligjshme dhe në ushtrim të detyrave funksionale në bazë të ligjit nr.8408, datë 25.09.1998 “Për policinë e ndërtimit”. Po ashtu edhe nga shoqëria ndërtuese në veprimet e saj për fillimin e ndërtimit të godinës së banimit, nuk konstatohet ndonjë veprim i paligjshëm. Për këto arsye, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 15.09.2004.

Ky vendim është i mbështetur në prova, pasi me vendimin nr. ***, datë 13.02.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është vendosur: *“Detyrimi i të paditurit V. Ç. t'i kthejë (lirorj e dorëzojë) personit të tretë, Shoqata e ***, dega Tiranë, stallën nr. ***, Laprakë”*.

Shoqata e *** ka lidhur kontratë për ndërtimin e një pallati për strehimin e ish-të dënuarve politikë, pasi ishte miratuar sheshi i ndërtimit me vendimin nr. ***, datë 04.02.2003 të K.RR.T-së së Bashkisë Tiranë. Shoqata ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep. e nr. ***kol, datë 11.12.2002 me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k.

Në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

• Denoncim tek ONM

Mbështetur në një denoncim të ardhur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitroit për çështjen e quajtur mediatikisht si “****”, në rubrikën e vlerësimit profesional është vlerësuar edhe përgjegjësia ligjore që ka patur znj. Alma Muça lidhur me organizimin e punës për këtë çështje shumë të përfolur.

Mediatikisht është bërë publik edhe lajmi se Prokurori i Përgjithshëm, i vënë në dijeni për situatën lidhur me qëndrimin e e prokurorit A. S. në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, ka urdhëruar menjëherë pezullimin e tij dhe të drejtorit Alma Muça, si edhe ka urdhëruar nisjen e hetimit për veprat penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve...” dhe “Shpërdorim detyre”, me qëllim për të zbuluar shkaqet e këtij qëndrimi.

Është pyetur subjekti znj. Alma Muça në pyetësorin e datës 29.10.2018 lidhur me përgjegjësinë që kishte ajo për organizimin e punës, si dhe marrëdhënien e saj me prokurorin e çështjes z.S. lidhur me këtë çështje.

Subjekti rivlerësimit në shpjegimet e datës 6 nëntor 2018 sqaron se është bërë drejtuese me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, në datën 12.1.2017, kohë në të cilën kishte hyrë në fuqi ligji nr. 97/2016. Kështu, marrëdhëniet e saj me vartësit kanë qenë ato që përcaktonte ky ligj, ku prokurori ka qenë tërësisht i pavarur në qëndrimin e tij.

Subjekti ka deklaruar se: *“Kam ushtruar detyrën në përputhje të plotë me ndryshimet e reja ligjore dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke respektuar pavarësinë e prokurorit, siç përcaktohet saktësisht në Kushtetutë dhe në ligj.”*

Lidhur me organizimin e punës për meaxhimin e çështjeve znj. Muça ka shpjeguar se: *“Për efekt të organizimit të punës edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.97/2016, prokurorët e drejtorisë më kanë njoftuar, në cilësinë e drejtueses, në përfundim të gjykimin të çështjeve, vendimin e Gjykatës së Lartë, shoqëruar me mendimin e dhënë prej tyre në seancë gjyqësore. Kjo është bërë për të ndjekur praktikën gjyqësore, në rast qëndrimesh për raste të ngjashme, për të evidentuar problematikat në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim dhe në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale e mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit, të cilat i bëhen prezent*

Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për të qenë në dijeni të punës së prokurorëve. (Bashkëlidhur disa njoftime dërguar në rrugë elektronike nga prokurorët). ”

Mbi diskutimet me prokurorin e çështjes për qëndrimin e tij në Gjykatën e Lartë, zonja Muça ka sqaruar se qëndrimi i prokurorit është tërësisht qëndrimi dhe bindja e tij dhe se ajo ka pranuar kërkesën e prokurorit për të diskutuar me si drejtuese, mbi opinionin e tij dhe të këshilltares ligjore.

Bazuar në thëniet e zonjës Muça para OPGJ -së së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda, dukej se znj. Muça nuk ka ndarë të njëjtin opinion me prokurorin e çështjes lidhur me qëndrimin e tij në Gjykatën e Lartë.

Kështu në rezultatet e hetimit, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar sqarime lidhur me qëndrimin e saj si drejtuese në Drejtorinë Gjyqësore, lidhur me këtë çështje. ***A duhej znj. Muça, në pozicionin e drejtueses, të vinte në dijeni apo të ndërmete veprime për të njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm para zhvillimit të seancës, nisur edhe nga faktet e bëra publike mbi reagimin e Prokurorit të Përgjithshëm?***

Në shpjegimet e saja znj. Muça ka shpjeguar se:

“Në rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, miratuar me urdhrin nr.46/3, datë 27.01.2015 të Prokurorit të Përgjithshëm, neni 19 “Funksionet e Drejtorisë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, në pikën 4 parashikohet se “Prokurorët e Drejtorisë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet t’i relatojnë Prokurorit të Përgjithshëm çështjet për përfaqësim përpara Gjykatës, si dhe qëndrimin e tyre paraprak edhe me shkrim”. Kjo rregullore është shfuqizuar me urdhrin nr.235, datë 02.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”.

Pra detyrimin për njoftimin paraprakisht, të mendimit me shkrim, të Prokurorit të Përgjithshëm, e kishte prokurori i seancës.”

Gjatë seancës dëgjimore e pyetur për këtë çështje znj. Muça ka shpjeguar:

“Siç ju thashë me ndryshimet e reja ligjore, prokurori, drejtuesi, eprori më mirë po them, epror mendoj që është termi më i gjetur, nuk ka një mjet ligjor që të ndikojë në qëndrimin e prokurorit në seancë gjyqësore, pikërisht për shkak të kësaj pavarësie, që është risia e mënyrës së organizimit të prokurorisë, me ndryshimet e reja ligjore, çka do të thotë që ne mes njëri- tjetrit, mund të organizojmë diskutime për çështje të ndryshme, të shkëmbejmë mendime për praktika të ndryshme që i bien gjithsecilit nga ne. Por në asnjë rast drejtuesi, eprori nuk mundet të ndikojë në qëndrimin e prokurorit të seancës, pasi edhe ligji vetë nuk parashikon për shkak të pavarësisë një mjet ligjor të tillë. Dhe në rastin konkret, madje- madje ligji parashikon që edhe në rastet kur jepen udhëzime për çështje konkrete, ato nuk janë të detyrueshme për prokurorin e çështjes, për prokurorin e seancës. Gjithsesi, nëse në raste konkret do të kishte mendime me shkrim të prokurorit për eprorin dhe nëse do shihej e arsyeshme mund të jepeshin dhe udhëzime me shkrim, por gjithmonë këto jo të detyrueshme. Kështu që, në pamundësinë ligjore për të ndikuar dhe për të ndërhyrë në çështje, qëndrimi im ka qenë, ai që unë kam paraqitur gjithmonë në komunikimet me ju dhe përfundimisht në shpjegimet përfundimtare.”

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

78. Nga vlerësimi në tërësi i çështjes, denoncimet e ardhura gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe informacionet e marra mediatikisht e të verifikuara nga Komisioni, trupi gjykues, gjykoi të

nevojshme të dërgojë pranë organit kompetent, për vlerësim, sjelljet e prokurores me cilësinë e drejtueses, lidhur me çështjen e vitit 2015 të njohur mediatikisht si “****”, ku sipas trupit gjykues, evidentohen shkaqe për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Muça, me funksion prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Transferimin e çështjes për kallëzimin penal të kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e vitit 2015 për çështjen e njohur mediatikisht si “****”, pranë organit kompetent për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit znj. Alma Muça.
3. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Pika 1 e vendimit mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 14.1.2019, ora 9:00.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUESE

Suela Zhegu

ANËTARE

Brunilda Bekteshi

RELATORE

Valbona Sanxhaktari

Sekretare gjyqësore

Fiorela Mandro